

SIR JOHN BAGOT GLUBB

# KERKIMI PËR MBIJETESË



BOTIMET BRERORE

SIR JOHN BAGOT GLUBB

# KËRKIMI PËR MBIJETESË

Një pjesë e dytë e domosdoshme

Përktheu: Juxhin Halo

Redaktoi: Faust

© Botimet Brerore

[brerore@outlook.com](mailto:brerore@outlook.com)

2021

## HYRJE

Dua të filloj duke falenderuar të gjithë ata që më shkruajtën mbi temën e artikullit tim të vitit 1976, “Fati i Perandorive”.

Fillimisht, u përpoqa t’i përgjigjesha çdo letre, por me kalimin e kohës kuptova se nuk mund t’a përballoja këtë mbingarkesë. Shpresoj që artikulli i mëposhtëm do të jetë i mjaftueshëm për t’iu përgjigjur disa prej komenteve.

Gjithsesi, ky kontribut nuk do të jetë një ese homogjene me argumente të njëpasnjëshme.

Është një dokument disi jo i qepur mirë. Do t’i përgjigjet kritikave të ndryshme, dhe sugjerimeve që kam marrë. Do të trajtojë në një masë të madhe çështje afatshkurtra dhe të kufizuara, sepse kjo ishte natyra e temave që u përmendën nga korrespondentët. Shumë njerëz më shkruajtën për të më pyetur se pse s’kisha parashikuar të ardhmen. Artikulli “Spektatori” (Maj 1977) sugjeron se të vish rrotull e rrotull duke përsëritur se fundi po afrohet, është diçka e padobishme. Disa lexues të tjerë patën mendimin se artikulli im ishte tepër pesimist.

Në fakt, mesazhi që dua të përcjell, është krejt i kundërt. Mund t’a shpëtojmë veten. Qartësisht, Britania do të vazhdojë të ekzistojë, por çështja është, a do të jetë e fortë, e bashkuar dhe e lirë?

Apo do të shndërrohet në një komb vartësish dhe lypsarësh? Përballlemi me shumë probleme, por ekziston një domosdoshmëri për t’i zbuluar dhe diagnostikuar, përpara se t’u kundërvihemi.

E kam ndarë këtë artikull në disa pjesë, ku secila i kushtohet çështjeve të ngritura nga korrespondentët. Fillohet me një diagnozë, dhe vazhdohet me propozimin e një zgjidhjeje.

- *Sir John Bagot Glubb*  
**1978**

## **I: Të mësoh nga historia**

### **Një histori e ngjarjeve të shkuara**

Ndoshta më duhet t'i kujtoj lexuesit se artikulli i mëparshëm, supozohej të ishte histori, që do të thotë, një përshkrim i ngjarjeve të shkuara. Këshilla ime e parë ishte se ne nuk mësojmë gjë nga historia, sepse studimet tona janë tepër të ngushta, zakonisht të kufizuara tek vendet tona. Ndoshta kjo prirje është gjithmonë e më në rritje. Kur ime bijë nisi të studioje histori në shkollë, e pyeta se cilën periudhë do të studioje. Ajo mu përgjigj, "Historia e bashkësive punëtore në Britani", një shembull i politikës bashkëkohore që maskohet si histori.

### **Teoritë përftohen nga eksperimentet**

Shkencat natyrore janë ngritur me anë të një numri të madh eksperimentesh, prej të cilëve janë zbuluar teori dhe ligje. Në mënyrë të ngjashme, unë besoj se historitë e kombeve të mëdha të së shkuarës duhet të studiohen metodikisht, me synim përfitim të teorive që do të na udhëzojnë. Gjithashtu do të udhëzojnë brezat e ardhshëm.

Rrjedhimisht, ideja ime fillestare ishte: *që historia të ketë kuptim, duhet të jetë historia e racës njerëzore që nga zanafilla e shkrimit.*

### **Shpërthime racore**

Shkaku kryesor i shpërthimeve të racave të prapambetura ka gjasa të jetë xhelozia. Më të pafatët dëshirojnë të zotërojnë përparësitë e qytetërimeve më të vjetra, të pasura e të fuqishme. Shanset kundra ardhacakëve duken tronditëse, por pse ishin pushtimet barbare kaq shpesh të suksesshme? Ndoshta një nga

arsyet, nëmos ajo kryesore, është se shtetet e vjetra priren të marrin trajta të ngurta dhe të dobësojnë ose të shkatërrojnë nismën dhe shtysën psikologjike vetjake. Përsa i përket viteve të fundit, mund të merret si shembull lufta e Vietnamit, gjatë së cilës Vietkongët u treguan më shumë nismëtarë e sipërmarrës se Amerikanët.

## **Luksi ushtarak**

Në rrafshin ushtarak, niveli i ndërlikuar dhe krahasimisht luksoz i trupave ka peshën e vet. Hasa dikur në një rast absurd. Kur po shoqëroja një kolonë ushtarake, arritëm para një grupi pusesh. Mjekët ushtarakë e gjykuan ujin si të papërshatshëm për ushtarët dhe u përdor një mënyrë e shtrenjtë e sjelljes së ujit nga ajri, me ndihmën e Forcave Ajrore Mbretërore.

Na shoqëronin një numër paraushtarakësh Arabë të cilët, bashkë me familjet e tyre, gjithmonë kishin pirë nga këto puse. Por duke qenë se tashmë iu ishin bashkëngjitur kolonës ushtarake, edhe atyre iu ndalua të pinin, uji iu soll edhe atyre nga ajri. Në mënyrë të ngjashme, ushtarët Britanikë duhet të hanin një vakt mish çdo ditë ndërsa për Arabët një grusht hurmash mjaftonin.

Është e lehtë të kuptohet si mbërritën këto kufizime në një ushtri e fuqi ajrore tepër të organizuar. Nëse një kolonë ka pirë nga pusët dhe tre burra sëmuren me tifo, jepet një urdhër i përgjithshëm që ndalon përdorimin e puseve vendase.

Oficerët mjekësorë, duke parë numrin e kalorive në racionet e ushtarëve, urdhëruan ndarjen e një sasive të caktuar mishi. Ndërkohë Arabët, që nuk kishin dëgjuar ndonjëherë për kaloritë, vazhduan secili me një grusht hurmash dhe kështu u përplasën me armikun.

Në llojet e veprimtarive ushtarake në të cilat morëm pjesë, qeveria fitoi falë burimeve të saj më të mëdha, por po këto veprimtari ushtarake vunë në pah vështirësitë që sjell makineria

e ndërlikuar e ushtrive të rregullta që i përket një kombi “të vjetër”.

## **II. Organizimi dhe Humbja e Nismës**

### **Nismë dhe vetëmjaftueshmëri**

Në luftë, guximi përplotëson dimensionin fizik. Rezultati përfundimtar do të varet nga energjia, entuziazmi dhe mbi të gjitha, nisma e ushtarëve. Nga ky këndvështrim, jemi të detyruar të pranojmë se çfarëdolloj organizimi ka gjasa t'a dobësojë nismën.

Kështu, sa më shumë që shteti është shtet i mirëqenies sociale, aq më shumë do t'a shkatërrojë nismën dhe vetëmjaftueshmërinë e qytetarëve. S'kemi nevojë të jemi ngurtësisht pro ose kundër shtetit të mirëqenies sociale. Partizanët janë zakonisht njerëz që shohin vetëm një anë të medaljes.

Nëse shqyrtojmë dilemën tonë në mënyrë të paanshme, mund të shohim sa e vështirë është për t'u zgjidhur. Është e lehtë të vlerësosh qëllimet dashamire të shtetit të mirëqenies sociale. Një shëtitje përmes lagjeve të varfra n'a bën të vlojmë nga zemërimi.

Ndiejmë se qeveria duhet të bëjë diçka, t'a vendosë nën kontroll zonën, t'i shpërngulë diku tjetër banorët dhe të krijojë një plan urbanistik alternativ. Në të njëjtën mënyrë, idealet e lirisë nga frika dhe lirisë nga nevoja tingëllojnë si të frymëzuara nga një ndjenjë bamirëse. Qytetari duhet të mbrohet nga gjithçka që rrezik se e shqetëson.

Nëse është i varfër, nevojat e tij duhet të plotësohen nga shteti. Në shtetin e përkryer të mirëqenies sociale, qytetari s'ka pse trembet nga asgjë. Ai thjesht mund të rehatohet dhe të ushqehet me lugë. Pastaj zbulojmë se ishte vetë frika dhe nevoja që prodhonin shtysën psikologjike dhe nismën vetjake.

## Çdo organizim e dobëson nismën

Përfundimisht kuptojmë se çdo lloj organizate pritet të zvogëlojë energjinë, nismën dhe sipërmarrjen e individit. Udhëçelësi priste pemët e pyllit dhe ndërtonte kasollen e tij me trungje, të cilën e mbronte nga Indianët e Kuq dhe kafshët e egra. Ai bëhej një burrë i vërtetë duke u mbështetur plotësisht tek përpjekjet vetjake.

Në shoqërinë tonë industriale, individi është i pashpresë. Puna e tij kufizohet në një punishte të mbyllur. Ai mund t'i bindet sindikatës, e cila mund të jetë një organizatë mbarëkombëtare me të cilën ai nuk ka ndonjë marrëdhënie personale. Nëse sëmuret ose pushohet nga puna, shteti i mirëqenies sociale ia plotëson nevojat. Ai nuk mund t'a braktisë punën duke u bërë i vetëpunësuar. Nëse përpiqet ta hedhë këtë hap, shteti i mirëqenies sociale e ndëshkon.

Tashmë ne mund të kuptojmë sa i vështirë është organizimi i industrisë. Kur një burrë dëshiron të fitojë bukën e gojës në mënyrë të pavarur, vetëm disiplinimi mund t'a ndalojë. Kështu, njerëzit që dëshirojnë të zhvillojnë nismën vetjake shtypen. Këto shqyrtime theksojnë thellësinë e dilemës sonë. Si mund të shmangë organizimin një komb industrial? Si mund të organizohet pa shkatërruar lirinë njerëzore dhe pa vrarë sipërmarrjen, nismën, guximin dhe vetëmbështetjen?

E prapësëprapë ky disiplinim dhe shkatërrim i nismës njerëzore frymëzohet (të paktën në Britani) nga qëllime të njerëzishme dhe dashamire. Në artikullin tim të mëparshëm, i'a mvesha dobësimin tonë një periudhe tepër të gjatë pasurie dhe pushteti. Jam ende i bindur se ky përfundim është i saktë. Ndoshta, sidoqoftë, duhet të shtojmë, “organizim dhe disiplinim i tepërt”.



### **III. Të Përcash Kombin**

#### **Sipërmarrja dhe acarimi i politikës**

Rrjedhimisht, duket se një nga pasojat e një periudhe të gjatë pasurie, pushteti dhe organizimi është dobësimi i sipërmarrjes dhe nismës. Fryma udhëçelëse nis të pushtojë botë të reja dhe të zbulojë burime të reja pasurie.

Mendësia dekadente nuk mendon më për sipërmarrje të reja. Lufton kundër vetes dhe nis të grindet mbi ndarjen e pasurisë së trashëguar nga paraardhësit. Shkruajta: “një simptomë e jashtëzakonshme dhe e papritur e dobësimit kombëtar është dendësimi i urrejtjeve të brendshme politike”.

Ky zhvillim më duket se ndodh për shkak të dy faktorëve:

a) Zëvendësimi i nderit, shërbimit ose aventurës me pasurimin si synim të jetës. Pasurimi është një veprimtari egoiste, e cila shkatërron frymën e shërbimit ndaj bashkësisë.

b) Humbja e nismës vetjake dhe vetëmbështetjes individuale. Një vetëmbështetje që do t'a shtynte të nisej drejt sipërmarrjeve të reja.

Rezultati është një zënkë e hidhur për pasurinë e mbetur. Nga këndvështrimi kombëtar ky është një fenomen shkatërrimtar.

Në vend që të qëndrojmë së bashku dhe të nxisim njerëzit tanë më të zotë të bëjnë zbulime të reja ose të fitojnë tregje të reja, i'a kushtojmë kohën zënkave mendjengushta. Teksa punëtorët në uzinat tona të automjeteve janë në grevë, Francezët, Gjermanët, Italianët dhe Japonezët pushtojnë dhe zaptojnë tregun tonë të brendshëm të automjeteve.

## **Udhëheqësi duhet t'i përfaqësojë të gjithë**

Kaq e ashpër bëhet kjo luftë brenda llojit sa që dëgjojmë prijësat politikë të një partie a një tjetre, t'i premtojnë mbështetësve të tyre se, nëse vijnë në pushtet, do të dëmtojnë gjysmën tjetër të kombit. Udhëheqësi i kombit, në çdo kohë, duhet të përfaqësojë të gjithë kombin.

Britania është qeverisur për shumë vite nga një sistem dypartiak, por kushtetuta teorike s'ka aq vlerë sa shpirti që frymëzon politikanët. Kur të gjithë ishin për kombin, dallime në mendim mbi politikën edhe kishte, por këto nuk çonin në grindje të cilat përcanin kombin.

## **Ndikimi i Kurorës**

Me hidhërimin në rritje të politikës partiake, Kurora është i vetmi autoritet që mbulon paanshmërisht të gjithë kombin. Hidhërimi i politikanëve vjen më shumë si pasojë e dëshirës së tyre për pushtet, klientelizëm dhe pasuri. Kombi vetë në thelb është i matur dhe dashamirës.

Pak njerëz, madje edhe në Britani, janë të vetëdijshëm mbi varësinë e lirive të tyre ndaj Kurorës. S'kanë ngelur shumë vende në botë të cilat, në një periudhë, nuk i janë nënshtruar një diktature ushtarake ose të paktën një shtabi të përgjithshëm ushtarak shumë të fuqishëm.

Në Britani, gjithsesi, forcat e armatosura i betohen Kurorës, dhe për rrjedhojë janë mbajtur jashtë politikave partiake. Partia politike në pushtet nuk mund të shkarkojë oficerë të forcave të armatosura dhe t'i zëvendësojë ata me oficerë partiakë ashtu siç ndodh në shumë vende të tjera.

Gjithashtu gjyqësori mund të ruajë pavarësinë e tij nga presionet politike. Prapëseprapë ekzistojnë politikanë që do të dëshironin t'i gërryenin të gjitha këto masa sigurie dhe t'i mbushnin forcat e armatosura dhe gjyqësorin me mbështetësit e

tyre. Bëjmë mirë të kujtojmë se në vitin 1649 Dhoma e Përfaqësuesve ekzekutoi Mbretin dhe shfuqizoi Dhomën e Lordëve.

Prapëseprapë kjo nuk solli një Dhomë Demokratike Përfaqësuesish që qeverisnin për hir të popullit. Përmbysja e kësaj kushtetute të balancuar çoi në shkrirjen e Dhomës së Përfaqësuesve dhe në dhjetë vjet diktaturë ushtarake.

### **Shkëputjet.**

Siç nxorra në pah, një nga problemet e kohës sonë është numri i pamasë i shteteve të vogla, secili me politikën e tij, pashaportat, doganat dhe monedhat. Një nga epërsitë kryesore të kombeve të mëdha është mbulimi i një territori të madh tregtar. Për aq kohë sa kombi është i begatë dhe me vetëbesim, të gjithë ndihen krenarë mbi përkatësinë e tyre.

Por sapo gjendja vështirësohet, është e habitshme se çfarë rivalitetesh të lashta ringjallen. Shfaqen lëvizjet shkëputëse, të cilat vishen me dinjtet përmes cilësimit të tyre si “çlirimtare”. Aty ku i’ a arrijnë qëllimit, këto lëvizje ngushtojnë edhe më tepër hapësirat ku mund të ekzistojë tregtia e lirë. Ato ngushtojnë mundësinë për paqe dhe begati. Ato e bëjnë mbrojtjen të pamundur.

Është e pamundur të udhëheqësh ushtri të copëzuara, të panumërta, me gjuhë të ndryshme, stërvitje, armatime dhe pajime të ndryshme. E njejta gjë vlen për flotat ushtarake të përbëra nga tre deri në katër anije, ose forcat ajrore me një gjysëm dyzinë skuadriljesh të përbëra nga mjete fluturuese të çuditshme.

### **Pak dhe saktë apo jo?**

Pasi i shërbeva Qeverisë së Jordanisë për 26 vjet, jam plotësisht i vetëdijshëm se vendet e vogla mund të jenë tërheqëse.

Në Shtetet e Bashkuara madje edhe në Britani individi nuk ka ndonjë vlerë.

Në një vend të vogël, të gjithë njohin njëri-tjetrin, pra udhëheqësit janë të afrueshëm dhe të njohur. Gjithsesi kundër-argumenti do ishte se vendet e vogla janë të prirura të jenë mendjengushta në pikëpamje. Nga ana tjetër, nevojat dërrmuese të tregtisë dhe mbrojtjes lypin gjithmonë e më tepër sipërfaqe toke të pashqetësuar nga regjimet doganore dhe pashaportat, dhe me forca të armatosura të njejësuar në mënyrë të përkryer.

Ndoshta mund të arrihen marrëveshje, duke lejuar ca autonomi vendore, bashkangjitur një bashkimi të përkryer për hir të tregtisë dhe mbrojtjes. Por në këto kohë të dhunshme, ndryshime të tilla duhet të kryhen me maturi dhe kujdes të jashtëzakonshëm. Qytetërimi ynë kërcënohet vazhdimisht nga terrorizmi dhe nga skuadrilje mjetesh fluturuese të çuditshme.

## **Komuniteti European**

Diskutimet në shtyp për sa i përket pjesëmarrjes së Britanisë në Komunitetin European duket se kufizohen zakonisht tek çmimi i sotëm i gjalpit ose mishit. Kjo dritëshkurtësi është e vajtueshme. Nëse e shqyrtojmë çështjen nga një këndvështrim më i gjerë, mund ta konsiderojmë si një reagim kundër copëzimit gjithmonë e më në rritje të shteteve, çka e bën mbrojtjen të pamundur duke pënguar tregtinë.

Shteti Romak ishte fillimisht një hegjemoni e drejtuar nga qyteti i Romës. Kur Republika Romake u shterpëzua dhe u korruptua, u shndërrua në Perandorinë Romake, e cila u bë një sipërfaqe e madhe, banorët e së cilës ishin qytetarë të barabartë dhe e gjitha ishte një treg i vetëm, me të njëjtat ligje, të njejtin organizim dhe të njejtën gjuhë zyrtare.

Në këtë mënyrë, pasuria, kultura, fuqia dhe siguria e shtetit Romak u ripërtëri. Në shpesh harrojmë se përpara Augustit, Republika Romake ishte e korruptuar, materialiste dhe e përçarë

nga brenda, me grindje të hidhura, ashtu sikur ne sot. Me shndërrimin e saj në një perandori Mesdhetare, të banuar nga raca të barabarta, paqja dhe begatia u rikthyen. Augusti gjeti një Romë të ndërtuar me tulla por e la të ndërtuar me mermer. Komuniteti European duhet shqyrtuar në kontekstin më të gjerë, më shtetar, të një ringjalljeje të mundshme të fuqisë dhe begatisë Europiano-Perëndimore.

### **Një superfuqi e vetme**

Një nga korrespondentët e mi. më pyeti se çfarë do të ndodhë kur të ngelet vetëm një superfuqi. Unë prirem të mendoj se kjo nuk do të ndodhë. Nëse një superfuqi arrin ndonjëherë të pushtojë botën nëpërmjet një luftë të rrufeshme, dyshoj se do të mund ta mbajë nën kontroll gjatë. Ka shumë kombëtarizma nëpër botë, të cilat në një periudhë apo në një tjetër do të shfaqeshin.

Armët e vogla. Pistoleta, thika dhe bombat do ishin përgjigjia ndaj armatimeve të mëdha shtypëse që gjunjëzuan botën. Pushtuesi i botës do të përballej me kryengritje lokale të panumërta të cilat do të shndërroheshin në luftra lokale, dhe do të ktheheshim përsëri aty ku e nisëm. Por vuajtjet njerëzore që do të vinin si pasojë e përmbyesjeve të tilla do të ishte e pallogaritshme.

### **Një ushtri e OKB-së**

Disa vite më parë, idealistët tanë po mbronin idenë e një ushtrie të OKB-së me qëllim disiplinimin e vendeve që nuk pranoinin ti bindeshin Organizatës. Fatmirësisht këtyre propozimeve duket se tani u ka kaluar koha. Një organizatë botërore e pajisur me mjete detyruese, do të ishte një dështim, ose një tirani e padurueshme

## **IV. Fuqia Detare**

### **Sundimi i deteve**

Një tjetër çështje e nxjerrë në pah në këtë letërkëmbim ka qenë ajo e fuqisë detare. Në artikullin tim të parë shkruajta: “Një nga mënyrat më dashamirëse me të cilat një superfuqi mund të mbrojë si paqen edhe tregtinë është nëpërmjet sundimit të deteve”.

Garnizonet ushtarake të ngritura nga një fuqi e madhe në një territor të varur rrezikojnë të ngjallin inatin e Whitehall-it. I vetmi kundërshtim ndaj kësaj manovre, erdhi për shkak të supozimit se luftrat e ardhshme do të ishin thjesht bërthamore, dhe se një raketë bërthamore mund të shkatërrojë me lehtësi secilën nga këto baza ishullore. Sipas këtij supozimi, një raketë bërthamore mund të shkatërrojë Londrën, Nju Jorkun, Moskën ose cilëndo fabrikë në cilindo vend.

Më mirë të heqim dorë nga jeta, duke qenë se së shpejti do të vdesim të gjithë. Në fakt, nuk jemi aq të sigurt se lufta e ardhshme do të jetë bërthamore dhe është e pakuptimtë të braktisen të gjitha planifikimet e zakonshme. Për më tepër, ruajtja e fuqisë detare Britanike dhe Amerikane përreth gjithë botës do të ishte një faktor madhor për parandalimin e çdo lufte të ardhshme botërore, bërthamore ose jo.

### **Sejshelet**

Ndërsa po shkruaja këto rreshta, shtypi shkruajti për një grusht shteti në Sejshele, një ish-koloni Britanike, tashmë një pjesëtare e Komonuelthit. Kreu i Shtetit ndodhej në Londër për Konferencën e Komonuelthit.

Sejshelet janë thjesht një grup ishujsh që mund të ishin përdorur si baza për fuqinë detare Anglo-Amerikane. Të vendosura në grykën e Gjirit Persik, ato sundojnë udhët e

lundrimet që të çojnë tek burimet naftëmbajtëse më të mëdha të botës.

## **Udha e naftës**

Sot Europa mbështetet kryesisht tek Lindja e Mesme për naftën, e cila sillet me çisterna duke kaluar përreth Kepit të Shpresës së Mirë. Flota Mbretërore është tërhequr nga Gjiri Persik dhe Oqeani Indian. Bazat detare dhe bashkëpunimi me Afrikën e Jugut janë braktisur për arsye ideologjike. Nafta me rëndësi jetike për Europën, i është braktisur fatit ose Rusëve.

## **Trashëgimia jonë e paçmueshme**

Një nga faktet më alarmante në shoqërinë moderne është shkalla e padijes dhe paaftësisë që shfaqet kaq shpesh tek politikanët që kombi vendos në pushtet. Ishte Britania që zbuloi e para fuqinë dashamirëse dhe paqeruajtëse të fuqisë detare. Ideja se detyra e Flotës Mbretërore ishte të mbronte Britaninë nga pushtimi Europian, vështirë se do të bindte qoftë edhe një fëmijë në shkollë fillore.

Falë valës së përgjithshme kundër imperializmit në Britani, pas Luftës së Dytë Botërore, trashëgimia jonë e paçmueshme, kaq jetike për ne dhe për paqen në botë, u hodh tutje pa e vrarë mendjen. Flotës Mbretërore ju mohua roli i saj bamirës gjatë një krize pamendjeje.

## **Neve thjesht nuk n'a e mban xhepi**

Këshillat për ruajtjen e fuqisë sonë detare, në veçanti në Oqeanin Indian, ndoshta do të priten me vërejtjen: “Shumë mirë. Por neve thjesht nuk na e mban xhepi”. Është njësoj sikur amvisa të thoshte, “Neve nuk na e mban xhepi të blejmë ushqime për familjen tonë sepse kemi kaq shumë pagesa mujore për të bërë

për makinën e re, televizorin me ngjyra dhe lavatriçen.” Është çështje prioritetesh. Britania i sjell nga jashtë naftën e lëndën e parë për industrinë e saj. dhe ushqimin nga përtej detit. Nëse nuk mund të mbrojmë këto gjëra të domosdoshme në det të hapur do të vdesim ose do të humbasim pavarësinë tonë.

Arsyeja pse nuk mund të paguajmë për mbrojtjen tonë, shumë të nevojshme, është dëshira që kemi të gjithë për më shumë para e më pak punë, *sa për të shijuar momentin*. Parrulla jonë duket se është: “Le të bëjmë qejf. Mund t’a paguajmë çmimin më vonë”. Nuk mund të mbijetojmë po të mos i analizojmë nevojat dhe detyrimet tona me seriozitet dhe largpamësi.



## **V. Etja për të Detyruar**

### **Liri apo detyrim**

Një nga prirjet më të pafata që përçojnë mendimin modern është mbështetja tek detyrimi. Nëse nuk biem dakort me dikë, përpiqemi t'a detyrojmë të pranojë mendimet tona, nëmos me armë, atëhere me greva, bllokada dhe braktisje. Besojmë se politikat e Afrikës së Jugut janë të gabuara, por nëse do të ishim aleatja dhe ortakja e saj, do të mund të ushtronim më tepër ndikim për ndryshimin e këtyre politikave, sesa ushtrojmë me anë të bojkotit dhe mospranimit.

Kjo mendjengushtësi është e jashtëzakonshme. Ne shpallim bujshëm lirinë e individit por nëse ndokush guxon të mendojë ndryshe, në çfarëdo mënyre, ne menjëherë shpallim një bllokadë, një grevë ose braktisje. Ne pretendojmë se dëshirojmë paqen e prapësëprapë vazhdimisht nxisim armiqtë të hidhura me mungesën tonë të tolerancës.

A nuk do ishte më mirë të ishim më të qetë, të arsyetonim, të diskutonim dhe të bindnim miqësisht, sesa të shpallnim ultimatume paraprake? A kemi të drejtë kur pretendojmë se gjithmonë dimë çfarë është më e mira dhe se të tjerët do bënin mirë të dakordësoheshin me ne?

Ne e marrim për të mirëqenë këtë mendësi në punët tona të brendshme po aq sa kur ndërveprojmë me kombe të huaja. Nëse Dhoma e Lordëve nuk e pranon një Ligj, dëgjojmë klithma për t'a shkrirë Dhomën e Sipërme. Për çikërrima, punëtorët shpallin një grevë zyrtare ose jozyrtare duke prodhuar mundime për bashkëkombasit e tjerë. Cilido nga ne duket se synon të jetë një diktator i vogël paçka se të gjithë e dënojmë me zhurmë diktaturën.

## **Përdorimi i dhunës**

Nuk do të flas mbi përdorimin e dhunës nga këndvështrimi moral. Pasoja e menjëhershme është vuajtja njerëzore dhe kjo është mjaftueshëm e qartë. Do ta shtjelloj vetëm sipas kotësisë së saj vetëshkatërruese. Sepse në përputhje me natyrën njerëzore, përdorimi i dhunës prodhon urrejtje.

Viktimat e dhunës hidhërohen duke ushqyer dëshirën për hakmarrje. Herët a vonë, urrejtja e tyre do të çojë në kundërdhunë e cila do të shkaktojë një tjetër valë kundërdhune që mund të zgjasë ndoshta për shekuj. Kështu, luftrat e Napoleonit mund të etiketohen si shkak i luftës Franko-Prusiane të vitit 1870 dhe i të dyja luftrave botërore.

Në vitin 1170, Harkforti, Baroni Norman i Pembroket, kaloi detin drejt Irlandës më kërkesë të Mbretit të Leinsterit, i cili ishte rrëzuar fqinji i tij, Mbreti i Konouht. Në vitin 1172, Henri i Dytë kaloi detin për në Irlandë. Pasojat e këtyre veprave të shkuara të dhunës na përndjekin deri në ditët e sotme.

E njëjta seri ngjarjesh mund të gjurmohet kudo përreth botës, në trajtën e armiqësive racore dhe gjakmarrjeve familjare e fisnore. Që dhuna nuk zgjidh gjë por shkakton më shumë dhunë është një ligj i kudogjendur njerëzor.

## **Nevoja për të qenë i fuqishëm**

Në të njëjtën kohë, pavarësisht se mund ta kuptojmë mënyrën sesi dhuna pjell më shumë dhunë, duhet gjithashtu të kuptojmë se shumë kombe synojnë t'a përdorin qëllimisht dhunën për të arritur synimet e tyre. Rrjedhimisht, braktisja ose zvogëlimi i skajshëm i forcave të armatosura nuk është mënyra e duhur për t'i dhënë fund luftrave, përkundrazi, ka mundësi t'i shtojë ato.

Kushdo që me vetëdije mbështetet vetëm tek dhuna, në këtë mënyrë, do të guxonte për t'u hedhur në sulm. Të zvogëlosh

forcat e armatosura që të shpenzosh të ardhurat e kursyera për të përmirësuar shoqërinë është dritëshkurtësi e rrezikshme. Mund të çojë në një luftë tjetër që do të sillte humbjen e gjithë shërbimeve tona shoqërore e me gjasë të pavarësisë sonë kombëtare gjithashtu.

Në këtë botë, fuqia ngjall respekt. Nëse paqja dhe braktisja e dhunës janë dëshira jonë e vërtetë, duhet të bëhemi të fortë që të na dëgjohet zëri. Sot për sot përballemi me të kundërtën. Askush nuk ua vë veshin qortimeve tona pikërisht për shkak të dobësisë sonë.

E prapësëprapë ne vazhdojmë t'u themi të gjithëve se si të sillen, a thua se jemi patriarku i gjithë kombeve. Në këtë mënyrë thjesht ngjallim përçmim dhe zemërim ndaj nesh. Këshillat e dhëna nga të dobëtit rrallë ndiqen.

## **VI. Energji dhe Udhëheqje**

### **Një rënie në energjinë fizike**

Mysafirët Europeanë në Londrën e fillimit të shekullit të nënëmbëdhjetë, habiteshin nga veprimtaria e dendur që shihnin. Të gjithë në Londër nxitoheshin.

Por në gjysmën e dytë të shekullit, kjo veçanti u zhvendos në Nju Jork, ku ritmi dhe trysnia e jetës thuhej se ishin pothuajse të papërballueshme. Por në numrin e Shkurtit të vitit 1977 të revistës Blekud, Zhan Gimpëll na thotë se në vitin 1956 burrat dhe gratë në rrugët e Shteteve të Bashkuara “po ecnin për në punë dhe po ktheheshin me hap të shkujdesur a thua se ishin në Romë dhe, ashtu si të ngjashmit e tyre në Paris, shumë drejtorë drekonin dy orë ose më tepër”.

Cilit shkak mund t’ia mveshim këtë dobësim të rregullt të energjisë tek kombet e vjetra? A është një dukuri fizike, pasojë e rehatisë dhe mbingopjes? Apo mos është një fenomen mendor dhe moral, një rënie në idealizëm dhe frymë?

Zbulojmë se në shumë drejtime, nuk mund t’i zgjidhim problemet tona sepse kurrë nuk kemi menduar në bazë të ngritjeve dhe rënive afatgjata të kombeve dhe kulturave. Shpresoj me sinqeritet që debati i tanishëm të mund të çojë në një ndryshim në studimet tona historike dhe në më tepër kërkime mbi ngritjen dhe rënien e kombeve përgjatë historisë. Studime të tilla mund të n’a ndihmojnë të zbulojmë shkaqet e dobësisë kombëtare dhe të n’a mundësojnë t’i shmangim ato.

### **Arti i humbur i udhëheqjes**

Sado të devotshëm të jenë njerëzit, sukcesi i punës së tyre pashmangshmërisht varet nga cilësia e udhëheqësve të tyre. Jam i bindur se çelësi i udhëheqjes qëndron tek parimi: “Më i madhi

midis jush le të trajtohet si i vogël, kurse shefi si shërbëtor ”. Udhëheqja nuk duhet të sjellë privilegje por detyra. Asnjë burrë nuk duhet t’i kërkojë vartësve të tij të bëjnë më tepër se ai vetë. Nëse puna nis në orën tetë të mëngjesit krerët duhet të jenë të përpiktë.

Nëse punëtorët hanë një drekë të shpejtë në mensë, krerët duhet të bëjnë të njëjtën gjë dhe jo të mungojnë dy orë për të ngrënë në një restorant. Të gjithë duhet të shijojnë punën e tyre të përditshme.

Kënaqësia varet nga marrëdhëniet ndërpersonale. Detyra e burrave të rëndësishëm është t’i bëjnë vartësit e tyre të lumtur duke i njohur personalisht dhe duke krijuar një frymë ortakërie dhe krenarie të ndërsjellë në punë.

Marrëdhëniet e ngrohta personale mund të përdoren nga burra të rëndësishëm për të diskutuar me vartësit e tyre mbi përparimin e punës, arritjet e tyre të ndërsjella dhe vështirësitë që i presin në të ardhmen. Një marrëdhënie në mirëbesim krijon një ndjenjë ortakërie dhe pune në ekip.

## **Murtaja e punës me shkresurina**

Një nga pengesat kryesore sot për udhëheqjen është sasia gjithmonë e më në rritje e shkresurinave që priret të ngulë pas tavolinës njerëzit vazhdimisht, e kështu të pengojë marrëdhëniet njerëzore. Kjo murtajë prek çdo pjesë të jetës sonë, industrinë, forcat e armatosura, kishën, administratën dhe pothuajse çdo veprimtari njerëzore. Asnjë sasi shkresurinash, planifikimesh ose statistikash s’mund të prodhojë ortakëri.

## **“Çlirim” nga zyra**

Kur drejtoja Legjionin Arab edhe unë vuaja nga rrjedha e pafundme e shkresave. Për më tepër që jeta e zyrës ishte tinëzare. Për t’u arratisur nga ky problem, e gjeta veten të detyruar të

zbatohet rregullat e mia në të jetuar. Tre ditë në javë i kaloja në zyrë. Tre ditët e tjera i kaloja duke takuar burrat në punë ose në fushim, pa marrë parasysh se sa shkresa kisha në tabaka. Po të lindte nevoja, me shkresat që tepronin mund të merresha në shtëpi pas pune. Drejtorët e ndërmarjeve dhe shërbyesit civilë duhet të kuptojnë, se duke kërkuar më tepër raporte dhe statistika, ata e bëjnë të pamundur për vartësit e tyre kryerjen e detyrave jetike.

## **Egoizëm**

Së fundi më erdhi një letër nga një mik në Shtetet e Bashkuara ku më thoshte se veçoria që shquan jetën në atë vend sot është egoizmi.

Ky tipar i çuditshëm më duket se vjen si pasojë e faktit se sigurimi i të ardhurave është bërë synimi kryesor i jetëve tona. Siç thashë në artikullin tim të parë, fitojmë para për veten tonë, jo për bashkësinë ose vendin tonë. Gjithsesi, ne mund t'a zgjerojmë akuzën e egoizmit, nga individët drejt konfederatave, drejt bashkësive punëtore dhe sipërmarrjeve.

Secila përqëndrohet tek interesat e pjesëtarëve të saj duke shpërfillur vendin si një të tërë dhe organizatat e tjera të ngjashme.

## **Nevoja për punë**

Parrulla e shkollës në të cilën mësova ishte *Labor Omnia Vincit* (Puna mposht gjithçka). Emigrantët aziatikë shpeshherë vijnë pa një dyshkë në Shtetet e Bashkuara, por brenda pesë ose gjashtë viteve pasurohen dhe sistemohen më së miri.

Arsyeja qëndron tek gatishmëria e tyre për të punuar ditë e natë, ndërkohë që Amerikanët vendas punojnë vetëm pak orë. Sindikatat e punëtorëve padyshim që kanë arritje të mëdha në

Britani por ato kanë ndikuar gjithashtu në dobësimin e saj, duke i shtyrë pjesëtarët të kufizojnë kohën e punës.

Një perspektive të dobishme i nevojitet punë, prodhim në rritje dhe një politikë energjike e zgjerimit. Një mendësi e tillë do të sillte grumbullim më të madh të pasurisë që nga ana e saj do të sillte rritje rrogash dhe mjedise urbane të përmirësuar.

Drejtorët e sipërmarrjeve që drekojnë dy orë dhe punëtorët e punishteve që kufizojnë prodhimin e tyre janë dy anë të së njejtës medalje, një dobësim i energjisë, dhe mbi të gjitha, i ngazëllimit.

Na duhen udhëheqës të dobishëm që mund të ngjallin tek kombi energji dhe ngazëllim të ri, ashtu si Uinston Çerçilli në fjalimin e tij të vitit 1940 për popullin Britanik, kur i'u tha se nuk "kishte gjë tjetër për t'iu dhënë veç gjakut, lodhjes, lotëve dhe djersës".

Politikanë që lypin vota duke u premtuar zgjedhësve më shume para, nuk mund të jenë udhëheqës të dobishëm. Qenies njerëzore mund t'i ngjallet ngazëllim vetëm përmes një thirrjeje buçitëse për të shërbyer dhe për t'u flijuar për një çështje fisnike.

## **Korrupsioni**

Një tjetër simptomë alarmuese në jetën tonë publike është shfaqja e mitmarrjes dhe korrupsionit.

Një cilësi e jashtëzakonshme që shquan nënpunësit civilë Britanikë për më tepër se një shekull ka qenë mungesa e mitmarrjes. Pasi kam jetuar për një pjesë të madhe të jetës sime në Lindjen e Mesme, kam dëgjuar pafund nga njerëzit e atyre vendeve, habinë dhe mahnitjen ndaj faktit se oficerët dhe zyrtarët Britanikë kurrë nuk merrnin rryshfet.

Mjerisht, në vitet e fundit, lexojmë mbi rritjen e numrit të rasteve të mitmarrjes dhe korrupsionit ku përfshihen nënpunës civilë Britanikë. Korrupsioni është një tumor që e shkatërron një komb nga brenda.

## **Intelektualizmi nuk mund të gjejë zgjidhje**

I paraqita mangësitë e intelektualizmit në artikullin tim të parë. Ne ndodhemi sot nën iluzionin se zgjuarsia njerëzore mund të n'ua shpëtojë. Një ideologji e re, shumë më tepër ligje të reja, më shumë planifikim intelektual, një ndërrim i partisë në pushtet. Këto paraqiten si zgjidhje për hallet tona. Politikanët nuk janë të gatshëm ose kanë frikë të pranojnë se rënia jonë vjen për shkak të humbjes së cilësive morale. E prapësëprapë, padyshim kjo është e vërteta.

Nuk ekziston ajo zgjuarsi mendore e mjaftueshme për t'i ripërtërirë madhësinë një kombi i cili ka humbur energjinë, nismën e, ndershmërinë e dhe mbi të gjitha dedikimin e tij ndaj shërbimit.

Shkruajta në artikullin e parë: “Vetëm gatishmëria për vetëflijim mund t'ia mundësojë mbijetesën një bashkësie”. Prandaj, problemet tona kanë të bëjnë me përmirësimin e pritshmërive morale dhe nxitjen e dedikimit ndaj shërbimit dhe flijimit.

## **T'i godasësh aty ku s'ua pret mendja**

Personalisht kam besim tek Britania. Sikur të mund të ndryshonim sjelljet tona të këqija dhe me vendosmëri t'i ndalnim zënkat tona të brendshme dhe t'i futeshim me energji punës. Unë besoj se do mund t'i godisnim gjithë kritizerët tanë aty ku nuk ua pret mendja.



## **VII. Vendi i Grave**

### **Feminizmi**

U habita nga komentet e pakta mbi vërejtjet e mia mbi rritjen e ndikimit të femrave në jetën publike gjatë kohëve të rrënimt kombëtar.

Përmenda se lëvizja feministe Arabe mori fund në mbarim të shekullit të IX-të, kur shkatërrimi i sigurisë publike e bëri daljen e pashoqëruar në rrugë të rrezikshme. Edhe një herë, nuk e dimë arsyen e shfaqjes së grave në jetën publike në kohët e degjenerimit sepse ngritja dhe rënia e kombeve nuk është studiuar kurrë nga historianët tanë. A mos degradojnë burrat e një kombi para grave?

### **Përmbysja e gjinive**

Rritja e përfaqësimit të grave në jetën publike duket se përkon me dëshirën nga ana e disa burrave për tu shtirur si gra. Në Bagdad kishte djelmosha që vishnin rroba grash dhe varëse me rruaza.

Kjo prirje mund të përkojë me një rritje të homoseksualitetit. Kjo quhet përmbysje e gjinive, burrat duan të jenë gra dhe gratë burra.

Sigurisht që shumica e burrave dhe grave vijojnë të martohen, të ndërtojnë familje dhe të kenë sjellje seksuale normale ndërmjet gjinive. Prapësëprapë, edhe pse vërejmë këtë dukuri, jemi të paaftë t'a shpjegojmë ose ta kurojmë.

### **Gratë dhe brezi i ardhshëm**

Kur mendojmë për të ardhmen kuptojmë rëndësine që kanë gratë në edukimin e brezit pasardhës. Dhjetë vitet e para të jetës vulosin karakterin e ardhshëm të një fëmije dhe gjatë atyre

viteve ndikimi i një nëne të mirë mund të jetë vendimtar. Me gjasë mund të themi në mirëbesim se karakteri i shumicës së burrave të mëdhenj të historisë ka ardhur si pasojë e edukimit amësor sesa falë shëmbullit atëror.

Për këtë arsye prirja moderne e grave me fëmijë të vegjël për të shkuar në punë, është shumë e rrezikshme për të ardhmen e kombit tonë.

### **Familje të rrënuara**

Numri gjithmonë e më në rritje i burrave dhe grave që braktisin bashkëshortët dhe fëmijët e tyre për tu arratisur me dikë tjetër përbën një alarm ogurzi për të ardhmen. Fëmijët që zvarriten poshtë e përjetë, rriten mendërisht të paqëndrueshëm, të acaruar, cinikë dhe me prirje kriminale.

Asnjë deklaratë s'është më larg të vërtetës se sa pohimi që *“moral i është punë për mua dhe askënd tjetër”*. Morali i secilit prej nesh është me rëndësi jetike për të ardhmen e vendit tonë.

### **Shërbim i fisëm dhe vetëmohues**

Na thuhet se Zoti na krijoi si meshkuj dhe femra. Por gratë për mendimin tim kanë kryer shërbimin më fisnik dhe vetëmohues, ato kanë qënë themeli jetik i kombit. Ato mundohen përditë duke punuar në shtëpi e rritur fëmijët pa u shpërblyer dukshëm dhe publikisht si burrat.

Pa dyshim që ndërgegjësimi mbi shërbimin vetëmohues të grave i dha shkas nderimit që ka ndodhur aty-këtu në të shkuarën. Por edhe midis nesh, veprime të tilla si hapja e dyerve për gratë, lejimi që ato të kalojnë të parat, heqja e kapeles ose lenia e ulëses, vinin si pasojë e së njejtës ndjesi.

Këto gjeste komunikojnë se kombi mbështetëj tek gratë, të cilat rrjedhimisht meritonin respektin dhe nderimin e burrave.

## **Më shumë “çlirim”**

Nga të gjitha zënkat e brendshme të cilave u kushtojmë kaq shumë kohë, më e kota me siguri është kërkesa për “çlirimin” e grave. Të dyja gjyshet e mia vdiqën para vitit 1910. por i mbaj mend mirë.

Sigurisht që asnjë ndjenjë inferioriteti nuk u shkoi nëpër mend ndonjëherë. Rrinin mbi kokat tona, si perandoresha, të buta dhe të dashura, mbi fëmijët, nipat dhe mbesat. I detyrohem nënës sime për të gjitha veprat e mira që mund të kem bërë në jetën time.

## **Gratë dhe kultura**

Ne duhet të mbajmë mend gjithashtu se gratë janë rojtaret e romancës, poezisë dhe kulturës. Cilido burrë që ka shërbyer në ushtri gjatë luftës ose në një rajon të largët ku nuk kishte gra, e kupton sesa të ashpër dhe të vrazhdë mund të bëhen burrat pa pasur ndikim femëror.

Burrat janë balta e zakonshme e racës njerëzore, druvarë dhe ujënxjerrës. Sa tragjike që gratë, engjëjt tanë mbrojtës, frymëzueset e të gjitha veprave tona të mira, dëshirojnë të zbresin nga vendi i tyre epran, dhe të shkrehen në baltën e një maratone të pistë e të padobishme.

## **VIII. Popullsia dhe e Ardhmja**

### **E papritura ndodh.**

Gjatë përpjekjeve për të diskutuar të ardhmen, vlen të vërehet se përgjatë gjithë historisë, burrat më të mençur të kohëve përkatëse kanë dështuar plotësisht në parashikimin e ngjarjeve.

Fati duket se gjithmonë ka një as të papritur nën mëngë. Kush qe i aftë të parashikonte dhjetë apo njëzet vjet më parë, pasurinë e beftë e të pamasë të grumbulluar nga Irani dhe Arabia shkretëtimore në tre ose katër vitet e fundit?

### **Mjete të udhëtimit dhe komunikimit**

Është e dukshme se mjetet moderne të udhëtimit dhe komunikimit do të ndikojnë thellësisht në të ardhmen. Disa njerëz parashikojnë krijimin e një race njerëzore të vetme që ndan një kulturë të përzier të përbashkët. Parashikime të tilla nuk janë gjë tjetër veçse hamendësime.

Shfaqja e një race dhe kulture të vetme mbi tokë për mendimin tim paralajmëron një njëtrajtshmëri dhe varfërim të jetës njerëzore. Gjithsesi, vlen të përmendet se afërsia nuk është domosdoshmërisht bashkëpunim apo vëllazërim. Grekët dhe Turqit kanë jetuar bashkë në Qipro për shekuj, vetëm në vitet e fundit janë armiqësuar dhunshëm.

Irlanda është një shembull tjetër i dy racave të cilat nuk janë përzier kurrë. Me gjasë, për një kohë të gjatë, lehtësia e udhëtimit nga një kontinent në tjetrin, mund të përfundojë në krijimin e shumë grupeve njerëzish prej racash të larmishme, të izoluar midis shumicave etnike të ndryshme.

## **A është integrimi i detyrueshëm një veprim i mençur?**

Qeveritë e Lindjes së Mesme gjithmonë e kanë kuptuar se njerëzit parapëlqejnë të jetojnë në bashkësitë përkatëse, krahas njerëzve që flasin të njejtën gjuhë, kanë të njejtat zakone, dhe të njejtën fe.

Çdo qytet kishte lagjet e veta të ndara për Arabët, Turqit, Armenët, Persët, Çerkezët, Hebrenjtë ose të Krishterët. Nuk hapeshin telashe nëse të gjithë trajtoheshin mirë nga një qeveri e paanshme. Është e qartë gjithsesi se të gjitha bashkësitë duhet të trajtohen barazisht, kur garantohen të mirat e përbashkëta si shkolla, rrugët dhe shërbimet bashkiake.

Nëse të gjithë trajtohen drejtësisht, jam thellësisht kundër përpjekjeve nga qeveritë burokratike për t'i strukturuar popujt me anë të dhunës.

## **Njëtrajtshmëria kombëtare**

Ideja e njëtrajtshmërisë kombëtare duket se vjen nga Perëndimi dhe ka prodhuar shumë probleme. Në Shtetet e Bashkuara, është përdorur ushtria për t'i detyruar fëmijët e bardhë e të zinj për të shkuar në të njejtat shkolla. Qeveria Izraelite dëboi qindra mijra arabë Palestinezë nga vendi i tyre me anë të forcës ushtarake.

Popullata e Izraelit duhej të ishte plotësisht Hebreje. Ideja intelektuale e njëtrajtshmërisë, në një periudhë të udhëtimit të shpejtë duket se është e destinuar të sjellë vetëm dhunë dhe urrejtje. Është e vërtetë se në artikullin tim të parë e konsiderova dyndjen e të huajve si një burim i dobësimi kombëtar, ashtu siç është me të vërtetë.

Prirem të mendoj njëtrajtshmëria kombëtare do ishte më e mirë. Në këtë mënyrë, nuk nënkuptoj përjashtimin e ashpër të të gjithë të huajve, të cilët mund të vijnë për të bërë tregti ose si ekspertë teknikë, por shpërnguljen e madhe të popullatave. Por

teksa udhëtimi bëhet më i lehtë dhe i shpejtë, popullatat e përziera mund të bëhen të pashmangshme. Në raste të tilla, toleranca e ndërsjellë e bashkësive të ndryshme duket më e matur se përpjekja për t'i integruar ato dhunshëm.

### **Popullsia botërore**

Njëri nga letërkëmbyesit e mi kritikoi mospërmendjen nga unë të rritjes së pamasë së popullsisë botërore. Edhe një herë, shfajësohem përmes faktit se po shkruaja historinë e të shkuarës. Më duhet të rrëfej sidoqoftë, se nuk e di se çfarë pasojash mund të sjellë në të ardhmen rritja e popullsisë botërore.

Zakonisht popullsia e kombeve më të sofistikuar nuk rritet. Rritja e madhe e popullatave të Azisë mund të jetë një rrezik për kombet e tjera.

## **IX. Fryma të Gjallëron.**

### **Ndikimi i frymës**

Në menaxhimin e çdo problemi, nuk është zgjuarsia e planifikimit që siguron sukses, por fryma që gjallëron njerëzit. Dashuria gjithmonë do t'a çelë një shteg. Na thuhet se dashuria është e durueshme dhe dashamirëse, nuk është xheloze, arrogante ose egoiste dhe nuk provokohet lehtësisht.

Deri në një farë mase, idealet e tanishme të Komonuelthit Britanik mbështeten tek kjo frymë, gjithmonë nëse udhëheqësit e tij mund t'i jenë besnikë. Mbi të gjitha, synon të mos përdorë detyrimin përveç se si mundësi e fundit ose më saktë, vetëm nëse është mënyra e vetme për të mbrojtur të dobëtin nga trajtat më të tmerrshme të shtypjes.

### **Një ringjallje e fesë**

Jam i bindur se standardet morale mund të rriten vetëm me anë të një ringjalljeje të fesë. Shtimi i “izmave” në kohët tona vërteton se asnjë ide politike çudibërëse nuk është e aftë të sjellë mbështetje të përgjithshme.

Një tufë njerëzish të zgjuar prodhojnë një teori mbi shoqërinë për të cilën ata janë të bindur se do të sjellë një parajsë tokësore, por është e pamundur të ndërtohet një shoqëri ëndrrash me njerëz të dhunshëm dhe egoistë. Teoritë e tyre sulmohen keqaz nga grupe të tjera dhe kjo gjë sjell përlëshje dhe urrejtje. Vetëm feja mund t'i bindë njerëzit të braktisin egoizmin e çastit dhe t'i përkushtohen të mirës së përbashkët me vetëmohim të plotë. Me fe, unë nënkuptoj bindjen se pas kësaj jete nuk vjen fundi, se ka një botë të shpirtit e cila edhe pse e padukshme, përshkon gjithë krijimin, që ngjall dhembshuri në çdo zemër njerëzore.

Pranimi i ekzistencës së kësaj bote shpirtërore zgjeron pafund fushëpamjet tona dhe na bën të kuptojmë vogëlsinë e zënkave tona dhe përpjekjeve për të kapur ç'të mundemi për veten tonë.

Mund të sjellë shndërrim të përshkallëzuar të personaliteteve tona. Por, shumicën e kohës, krenaria n'a i mbyll sytë ndaj botës shpirtërore që na rrethon dhe mbështjell kudo.

### **Një mesazh shpresëdhënës**

Prandaj, qëllimi i artikullit tim të pare nuk ishte të rënkoja mbi “afrimin e fundit” por krejt e kundërta. Dobësia jonë nuk vjen për shkak të forcave të jashtme të cilat nuk i kontrollojmë dot por për shkak të lakmisë, egoizmit dhe imoralitetit tonë, si dhe për shkak të humbjes së guximit dhe energjisë. “Fajin, i dashur Brut, nuk e kanë yjet por vetja jonë”.

Këto janë të metat që secili nga ne mund t'i ndreqë. Kështu, detyra jonë është të përurojmë lëvizje që i ndryshojnë këto prirje. Të kryejmë me zell detyrat ndaj familjeve tona. Të punojmë aq sa të mundemi, t'i mbajmë afër vartësit tanë, si ortakë e si shokë. Të shfrytëzojmë çdo mundësi për të folur e shkruar për të mirat e shërbimit dhe vetëmohimit.

Mbi të gjitha qëndron ringjallja e frymës sonë, që do të ndryshojë rrethanat duke siguruar të ardhmen tonë. Vendi jonë ndodhet nën pushtimin e postulatit “Pse duhet ta bëj unë?”. Na duhen prijësa që të na frymëzojnë edhe një herë që të shërbejmë me vetëmohim.

Nëse udhëheqësit tanë janë të paaftë për të dhënë këtë shembull, atëhere duhet t'a bëjmë vetë. Na duhet fryma e profetit i cili kur dëgjoi se nevojitej shërbim i rëndë, klithi plot gëzim: “Ja ku jam! Më dërgoni mua!”



## Përmbledhje

1. Duhet ndryshuar perspektiva mbi historinë, në mënyrë që të përfshijë historinë e gjithë racës njerëzore.

2. Pa dyshim që një kohë e gjatë pushteti e pasurie çon në degjenerim. Duhet të zbulojmë se si kjo gjë ndodh, dhe të marrim masa për t'a shmangur.

3. Kombet e vjetra vuajnë nga ndrydhja për shkak të organizimit, trajtave të ngurta dhe një burokracie gjithmonë e më në rritje që shkatërrojnë nismën vetjake dhe shtysën mendore.

4. Forcat e armatosura të pajtuara nga një shtet i mirëqenies sociale, priren të humbasin nismën. Një nivel shumë luksoz i jetesës i dobëson.

5. Organizimi i tepërt nga sipër priret të shkatërrojë nismën. Një nga problemet tona kryesore është shmangia e mbiorganizimit në një komb industrial.

6. Mund ti vlerësojmë qëllimet njerëzore dhe dashamirëse të shtetit të mirëqenies sociale duke qenë në të njëjtën kohë të vetëdijshëm se një popullsi që ushqehet me lugë nga shteti humbet nismën vetjake.

7. Kombe të degjeneruara rreshtin së kërkuari për burime të reja të pasurimit. Energjitë e tyre shterojnë gjatë zënkave të hidhura mbi pasurinë e trashëguar.

8. Ndikimi i Kurorës është i paanshëm e si pasojë me vlerë.

9. Si siguria ashtu dhe begatia lypin hapësira të gjera të bashkuara nën flamurin e tregtisë së lirë. Prirja për tu ndarë në copa gjithmonë e më të vogla rrit varfërinë dhe pasigurinë.

10. Komuniteti European nuk është një mekanizëm që ul çmimet e ushqimeve në Britani. Synimi i tij është të krijojë një hapësirë më të gjerë tregtare, me qëllim integrimin më të mirë të masave mbrojtëse Europiane.

11. Garancia më e mirë për paqen botërore dhe tregtinë e lirë do të ishte sundimi Anglo-Amerikan i deteve. Kjo e vërtetë,

themeli i madhështisë së shkuar të Britanisë, duket se nuk kuptohet nga politikanët tanë modernë.

12. Edhe pse flasim për lirinë, një nga prirjet moderne më shkatërrimtare është përdorimi i detyrimit, qoftë me anë të armëve, me anë të grevave, bllokadave ose braktisjeve. Arsyetimi, biseda dhe bindja miqësore sjellin rezultate më të mira dhe afatgjata. Por që të dëgjohemi duhet të jemi të fortë.

13. Një tipar i dukshëm i kombeve në rënie është humbja e energjisë fizike. Ne nuk e dimë me siguri arsyen pse, për shkak se rënia kombëtare nuk është bërë ndonjëherë synim i kërkimeve historike.

14. Çdokush prej nesh mund të ndihmojë në ripërtëritjen e kombit, duke punuar më shumë dhe duke ushqyer një ndjenjë ortakërie dhe pune në grup.

15. Mitmarrja dhe korrupsioni në jetën publike janë dukuri të reja në Britani. Nuk mund të zhduken duke shtuar ligjet ose ndëshkimet, por vetëm përmes përhapjes së pritshmërive më të larta morale.

16. Përfshirja më e madhe e grave në jetën publike duket se ka qenë një shenjë e rënies së kombeve në të shkuarën. Nuk e shpjegojmë dot përmbysjen e gjinive sepse nuk ka studime në këtë.

17. Gratë janë rojtaret e së ardhmes, në sajë të devotshmërisë me të cilën ato rrisin fëmijët. Kur gratë shpërfillin fëmijët e vegjël që të fitojnë një rrogë shtesë për familjen, rreziku shtohet shumë, për brezin e ardhshëm.

18. Burrat duhet t'i nderojnë gratë për shërbimin e tyre fisnik e vetëmohues. Gratë nga ana tjetër do ishte mirë mos të zbrisnin nga vendi i tyre epran.

19. Lehtësia e udhëtimit dhe rritja e popullsisë botërore mund të çojë pashmangshmërisht në popullata të përziara. Kjo prirje paraqet shumë rreziqe për ndasi dhe urrejtje të brendshme. Do ishte mirë që njerëzit të lejohen të jetojnë ashtu siç duan, dhe në bashkësi të ndara, sesa të detyrohen për t'u integruar.

20. Dashuria, durimi dhe dashamirësia gjithmonë do t'a gjejnë një rrugëdalje. Idealet e Komonuelthit Britanik mbështeten tek kjo frymë.

21. Vetëm një ringjallje e devotshmërisë shpirtërore e jo "izmat" që janë në modë mund të frymëzojnë vetëmohimin.

22. Secili nga ne mund bëhet shembull duke bërë me devotshmëri një jetë të moralshme. Duke folur e shkruar po kështu. **Nëse s'kemi prijësa që të n'a frymëzojnë, duhet t'i futemi vetë punës.**